

VENDIM
Nr. 121, datë 6.3.2024

PËR NJË NDRYSHIM DHE NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 1128, DATË 30.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ZBATIMIN NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË TË VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN, PËR VENDOSJEN, NDRYSHIMIN DHE SHFUQIZIMIN E MASAVE SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE, TË NDRYSHUARA”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 3, shkronja “c”, e 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimi dhe shtesa, e mëposhtme:

1. Pika 27, e kreut I, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“27. Vendimi i Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2011/72, “Për vendosjen e masave kufizuese të drejtuara kundër disa personave dhe subjekteve të caktuara në funksion të situatës në Tunizi”, i ndryshuar me vendimet e Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2022/1367, (CFSP) 2022/2086, (CFSP) 2023/159, (CFSP) 2024/421, sipas aneksit 27, bashkëlidhur këtij vendimi.”.

2. Në aneksin 27, bashkëlidhur vendimit, shtohet vendimi (CFSP) 2024/421, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



2024/421

30.1.2024

VENDIM I KËSHILLIT (CFSP) 2024/421

i 29 janarit 2024

**për ndryshimin e Vendimit 2011/72/CFSP lidhur me masat kufizuese të drejtuara kundër disa
personave dhe subjekteve të caktuara në funksion të situatës në Tunizi**

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Politikën e Punëve të Jashtme dhe të Sigurisë,

Ndërsa:

- (1) Më 31 janar 2011, Këshilli miratoi Vendimin 2011/72/CFSP ⁽¹⁾ në lidhje me masat kufizuese të drejtuara kundër personave dhe subjekteve të caktuara në funksion të situatës në Tunizi.
- (2) Në bazë të rishikimit të Vendimit 2011/72/CFSP, masat kufizuese duhet të zgjaten deri më 31 janar 2025 dhe, në aneksin e atij vendimi, shënimet për tre persona duhet të fshihen.
- (3) Vendimi 2011/72/CFSP duhet të ndryshohet në përputhje me rrethanat,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1

Vendimi 2011/72/CFSP ndryshohet si më poshtë:

(1) Neni 5 zëvendësohet si vijon:

'Neni 5

1. Ky vendim do të zbatohet deri më 31 janar 2025.

2. Ky vendim do të mbahet në shqyrtim të vazhdueshëm. Ai mund të rinovohet ose ndryshohet, sipas rastit, nëse Këshilli gjykon se objektivat e tij nuk janë përmbushur;

(2) Shtojca ndryshohet në përputhje me aneksin e këtij vendimi.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi një ditë pas publikimit të tij në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Bërë në Bruksel, më 29 janar 2024

Për Këshillin
Presidenti
H. LAHBIB

(¹) Vendimi i Këshillit 2011/72/CFSP i 31 janarit 2011 në lidhje me masat kufizuese të drejtuara kundër personave dhe subjekteve të caktuara në funksion të situatës në Tunizi (OJ L 28, 2.2.2011, f. 62).

ANEKS

Në seksionet A dhe B të Aneksit të Vendimit 2011/72/CFSP, shënimet për personat e mëposhtëm fshihen:

14. Samira Bent Mohamed Ben Rhouma TRABELSI;

26. Dorsaf Bent Zine El Abidin Ben Haj Hamda BEN ALI;

27. Sirine (Cyrine) Bent Zine El Abidine Ben Haj Hamda BEN ALI.



2024/421

30.1.2024

COUNCIL DECISION (CFSP) 2024/421

of 29 January 2024

amending Decision 2011/72/CFSP concerning restrictive measures directed against certain persons and entities in view of the situation in Tunisia

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

- (1) On 31 January 2011, the Council adopted Decision 2011/72/CFSP ⁽¹⁾ concerning restrictive measures directed against certain persons and entities in view of the situation in Tunisia.
- (2) On the basis of a review of Decision 2011/72/CFSP, the restrictive measures should be extended until 31 January 2025 and, in the Annex to that Decision, the entries for three persons should be deleted.
- (3) Decision 2011/72/CFSP should therefore be amended accordingly,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

Article 1

Decision 2011/72/CFSP is amended as follows:

- (1) Article 5 is replaced by the following:

'Article 5

1. This Decision shall apply until 31 January 2025.
 2. This Decision shall be kept under constant review. It may be renewed or amended, as appropriate, if the Council deems that its objectives have not been met.;
- (2) the Annex is amended in accordance with the Annex to this Decision.

Article 2

This Decision shall enter into force on the day following that of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

Done at Brussels, 29 January 2024.

For the Council
The President
H. LAHBIB

⁽¹⁾ Council Decision 2011/72/CFSP of 31 January 2011 concerning restrictive measures directed against certain persons and entities in view of the situation in Tunisia (OJ L 28, 2.2.2011, p. 62).

ANNEX

In sections A and B of the Annex to Decision 2011/72/CFSP, the entries for the following persons are deleted:

- 14. Samira Bent Mohamed Ben Rhouma TRABELSI;
 - 26. Dorsaf Bent Zine El Abidine Ben Haj Hamda BEN ALLI;
 - 27. Sirine (Cyrine) Bent Zine El Abidine Ben Haj Hamda BEN ALLI.
-